

VENDIM
Nr. 19, datë 10.3.2016

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE, NGA GRANTI
“SHËNDETËSIA”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS
VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE, PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes së parë, për financimin e projekteve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, si më poshtë vijon:

1.1 Granti 3: “Shëndetësia (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor)”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I.

2. Aplikimi për financimin e projekteve, përmes këtij granti, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas kalendarit të dhënë në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Procedura e vlerësimit të projekteve të aplikuara, kryhet pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Shëndetësisë, sipas kritereve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Ngarkohet ministri i Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Shtojcë I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në “Fletoren zyrtare”	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte në grantin, programin dhe shtyllën e financimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.
1 Prill 2016 (afat për projektet e pikës 1.2)	Aplikuesit sipas pikës 2 të këtij vendimi, si më sipër.	Dërgimi e aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi online në faqen elektronike te e-albania: Shërbimi: Aplikimi online për FZHR https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203 . Ose 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë sekretariatit teknik përkatës, si më poshtë vijon: a) Shtylla 1 - “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale”, - granti 3: “Shëndetësia”, sekretariati teknik pranë Ministrisë së Shëndetësisë Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, <u>nuk dorëzohen dosjet e aplikimit, por vetëm pranë sekretariatit teknik.</u>
3 ditë pune nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi tekniko - financiar e ligjor, i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim.
3 ditë pune nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Zhvillimit dhe Planifikimit Strategjik)	Në bashkëpunim me sekretariatit teknik organizon mbledhjen e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Shtojcë II:
FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET
Ky format plotësohet për të gjitha projektet

Aplikuesi (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Data e aplikimit (*)	Përcaktohet automatikisht nga sistemi.
Titulli i projektit (*)	
Shtylla e Financimit (*)	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet. (sipas Aneksit 3 të Ligjit nr.147, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016") dhe vendimit përkatës të KZHR.
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin program aplikohet. (sipas Aneksit 3 të Ligjit nr.147, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016"), dhe vendimit përkatës të KZHR.
Granti i projektit (*)	Të përcaktohet për cilin grant aplikohet (sipas Aneksit 3 të Ligjit nr.147, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016"), dhe vendimit përkatës të KZHR.
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmblajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Risqet për zbatimin e tij; Informacion në lidhje me pronësinë e tokës (nqs parashikohet ndërtimi i një objekti të ri), dhe lirimi i sheshit të ndërtimit, nëse krijon vonesa në zbatimin e punimeve, krijon kosto shtesë (kosto e shpronësimit), si dhe deklarin mbi zgjidhjet për mbulimin e koston së shpronësimit (në formular).
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 projekti për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet, nëse për këtë projekt aplikuesi parashikon dhe deklaron (në formular) se mbulon: - Koston për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, vlera që kërkohet për financim është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësi e qeverisjes vendore	Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësi qendrore, vendore, donatorë apo nga organizata të tjera zhvillimi
Financim nga donatorë (opsionale, nqs ka donatore)	Të jepet vlera e bashkëfinancimit në monedhën lekë.
Financime të tjera (opsionale, nqs ka donatore)	Të jepet vlera e financimit në monedhën lekë.

Kostoja totale e projektit (*)/Vlera që kërkohet për financim nga projekti	
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim (Opsionale)	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë
Deklarime. (*)	Aplikanti deklaron se: i. projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin e punimeve; ii. Projekti është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës, është pjesë e planeve vendore të zhvillimit, dhe/ose të investimeve. Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues siguron pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit të fuqi. iii. Janë zbatuar cmimet e referencës dhe legjislacioni në fuqi për përlllogaritjen e koston dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentet teknike, etj. (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - projektin teknik/projektin e zbatimit - preventivin - argumentimin teknik
Koordinatat e projektit (*)	Të hidhen koordinatat e vendodhjes së projektit, sipas sistemit të gjeoreferencuar, në formë teksti
Foto – Gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf
Pamje 3 Dimensionale (*) i detyrueshëm përveç programit Shqipëria Dixhitale	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf

SHËNIM: Dërgimi i Aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

- a) Aplikimi online në faqen elektronike të e-albania. Shërbimi: Aplikimi online për FZHR (<https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203>.)

Ose

- b) Me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit të hedhur në CD, pranë sekretariatit teknik përkatës.

Shtojca III:

KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE (Shtylla 1 e Financimit: Zhvillimi Vendor dhe Rajonal)

A. Kriteret e vlerësimit për projektet

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 90 pikë**. Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë ministrisë së Shëndetësisë, sipas aneksit 3, të ligjit nr.147, datë 17.12.2015. Këto kritere konsistojnë në standardet teknike të domosdoshme për të propozuar një projekt për financim.

Kriteret për vlerësimin teknik të projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
2. Përputhja me drejtimit e thirrjes dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
3. Ndikimi i projektit në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor ndaj qytetarëve, cilësinë e jetës, shëndetin, numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri **bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 20 pikë**.
4. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi rriskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.
5. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri **bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.
6. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve. Vlerësimi sipas këtij kriteri **bëhet me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

B. Kriteret e vlerësimit të impaktit

Sekretariati i Përgjithshëm kryen vlerësimin e impaktit të projektit, **me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë**.

SHËNIM – Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi teknik, ligjor, dhe financiar i projekteve, në zbatim të Ligjit për buxhetin, dhe vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, kryhet nga sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Shëndetësisë, sipas kritereve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit.
2. Sekretariati teknik i paraqet Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, listën e plotë të projekteve që propozohen për financim, në përfundim të procesit të vlerësimit.
3. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në bashkëpunim me sekretariatit teknik, merr masat për organizimin e mbledhjes së Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas komunikimit zyrtar të sekretariatit teknik.